LIGJ
Nr.9679, datë 22.1.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR PJESËMARRJEN NË FINANCIMIN E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT TË PORTIT TË PESHKIMIT, DURRËS, SHQIPËRI"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për pjesëmarrjen në financimin e projektit të ndërtimit të portit të peshkimit, Durrës, Shqipëri".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5200, datë 2.2.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

Projekti nr. ALB 020/Kredi
S:\Fagrts\Loan\Alb - 020(LN - Ord).rtf (06/02/2006 8:02M)

MARRËVESHJE KREDIE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT TË PORTIT TË PESHKIMIT NË DURRËS, SHQIPËRI

Kjo Marrëveshje nënshkruhet më __/___/1425 H, e cila i përkon __/__/2006 G, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu e tutje i quajtur "Huamarrës") dhe Bankës Islamike për Zhvillim (këtu e tutje referuar si "Banka").

Ndërsa:

A) Huamarrësi i ka kërkuar Bankës ta ndihmojë për mbulimin e kostos së financimit të Projektit të portit të peshkimit në Durrës (këtu e tutje të quajtur "Projekti"), sipas përshkrimit në tabelën – I të kësaj Marrëveshjeje duke i siguruar huanë e dhënë më poshtë;

B) Një nga qëllimet e Bankës është që t'i ndihmojë vendet e veta anëtare, duke livruar hua për financime të projekteve dhe programeve të rëndësishme;

C) Projekti konsiderohet të jetë teknikisht i bazuar, gjithashtu i përligjur nga pikëpamja ekonomike dhe shoqërore;

D) Banka ka rënë dakord, mbështetur edhe në sa më sipër, t'i japë Huamarrësit huanë bazuar në termat dhe kushtet e paraqitura më poshtë.

Për këto arsye, Palët janë marrë vesh për sa më poshtë vijon:

Neni 1
Përkufizimet, kushtet e përgjithshme

Seksioni 1.01 Përkufizimet: Kudo ku janë përdorur në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur nga konteksti rezulton ndryshe, përkufizimet e dhëna në kushtet e përgjithshme kanë kuptimet e caktuara, që jepen si më poshtë vijon:

"Disbursim" nënkupton tërheqjen e shumës së huasë.

"Procedurë e disbursimit" nënkupton procedurën e disbursimit të Bankës.

"Data e vlefshme" nënkupton datën në të cilën Marrëveshja deklarohet e vlefshme nga Banka dhe i komunikohet si e tillë Huamarrësit nga Banka.

"Agjencia zbatuese" nënkupton Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) të Republikës së Shqipërisë, që është institucioni zbatues përgjegjës për zbatimin, realizimin dhe drejtimin, ose cilido institucion tjetër për të cilin bihet dakord nga Kredimarrësi dhe Banka.

"Kushte të përgjithshme" nënkuptojnë kushtet e përgjithshme të zbatueshme për hua dhe marrëveshje garancie të Bankës që i përkasin datës 8.11.1976.

"Dinari islamik/DI", siç përkufizohet në nenin 4 (1) (a) të marrëveshjes themeluese të Bankës, është njësia për llogaritë e Bankës. Një DI është i barabartë me një të drejtë të veçantë të përfaqësimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

"Shuma e huasë" nënkupton shumën për të cilën Banka ka rënë dakord t'i japë Kredimarrësit në mënyrën e përcaktuar në seksionin 2.01 të kësaj Marrëveshjeje.

"Shuma fillestare" nënkupton shumën në total të kredisë, aktualisht e tërhequr nga Huamarrësi në përputhje me këtë Marrëveshje.

"Udhëzime të prokurimit" nënkuptojnë udhëzimet për prokurim të mallrave dhe shërbimeve të financuara nga Banka.

"Projekti" dhe referime në "pjesë" të tij nënkupton Projektin dhe pjesë të tij, ashtu siç janë përshkruar në tabelën I të kësaj Marrëveshjeje.

"Tarifa e shërbimit" nënkupton tarifën që i paguhet Bankës nga Huamarrësi, ashtu siç përcaktohet në seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02 Kushte të përgjithshme: Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha dispozitat e kushteve të përgjithshme si njëlloj të vlefshme dhe efektive, ashtu siç paraqiten në vijim.

Neni 2
Huaja

Seksioni 2.01 Shuma e kredisë. Banka bie dakord t'i japë Huamarrësit hua nga burimet e veta të zakonshme, në një shumë që nuk tejkalon barasvlerën e DI 6,13 - (gjashtë milionë e njëqind e tridhjetë mijë dinarë islamikë) vetëm sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Seksioni 2.02 Përveç rastit kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, kontratat për mallra dhe shërbime që do të financohen nga marrëveshja e huasë, do të prokurohen me anë të procedurave në përputhje me udhëzuesit e prokurimit të Bankës. Në këtë kontekst, Huamarrësi do t'i përmbahet rregullave të Organizatës së Konferencës Islamike lidhur me bojkotin ndaj shtetit të Izraelit.

Neni 3
Tërheqja dhe përdorimi i shumës së kredisë

Seksioni 3.01 Tërheqja. Shuma e kredisë do të tërhiqet nga Huamarrësi sipas tabelës - III dhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, kushteve të përgjithshme dhe procedurës së disbursimit, për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, për shpenzimet e bëra lidhur me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për projektin, për t'u financuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Data për kërkimin e disbursimit të parë. Nëse brenda 180 ditëve nga

data e vlefshmërisë ose çdo date tjetër e mëvonshme, siç do të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, Huamarrësi nuk i paraqet Bankës një kërkesë për të bërë disbursimin e parë, Banka ka të drejtë ta pushojë këtë Marrëveshje në bazë të njoftimit përkatës drejtuar Huamarrësit.

Seksioni 3.03 Data e përfundimit të disbursimit. 31/12/2010 ose një datë e mëvonshme për të cilën do të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, është data përfundimtare e tërheqjes nga shuma e huasë për qëllime të seksionit 6.03 (c) të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 3.04 Përdorimi i shumës së kredisë: Të gjitha shumat e tërhequra nga Huamarrësi do të përdoren vetëm për qëllime të projektit të financuar nga Banka.

Neni 4
Amortizimi, tarifa e shërbimit dhe vendet e pagesave

Seksioni 4.01 Amortizimi. Huamarrësi do të ripaguajë shumën fillestare në 25 (njëzet e pesë) vjet, duke përfshirë një periudhë shtyrjeje 7-vjeçare, e cila fillon nga data e kësaj Marrëveshjeje, në 36 (tridhjetë e gjashtë) këste të barabarta dhe të pandërprera gjashtëmujore siç parashikohet në tabelën - II (A) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.02 Tarifa e shërbimit

a) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një tarifë shërbimi në një shumë të vlerësuar fillimisht në DI 558,700.46 (pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind, pikë dyzet e gjashtë dinarë islamikë), sipas mënyrës së përcaktuar në tabelën II (B) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Nga Palët në këtë Marrëveshje bihet dakord dhe kuptohet se shuma fillestare e tarifës së shërbimit, e referuar në nënseksionin 4.02 (a), është veçse një vlerësim i bazuar në prezumimin e periudhës së zbatimit dhe të periudhës së disbursimit të shumës së plotë të kredisë siç është parashikuar këtu. Gjithashtu bihet dakord se shuma reale e tarifës së shërbimit do të përllogaritet pas zbatimit të Projektit, duke marrë në konsideratë faktin që kjo shumë nuk do të tejkalojë 2.5% (dy pikë pesë për qind) të shumës vjetore të kredisë.

c) Tarifa e shërbimit do të akumulohet nga data e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.03 Vendet e pagesave. Çdo pagesë, duke përfshirë këtu edhe rikthimin e shumës themelore, do të konsiderohet e shlyer kur fondet përkatëse të këtyre pagesave të jenë kredituar në një llogari të përcaktuar për këtë qëllim nga Banka.

Seksioni 4.04 Pa cenuar tërësinë e dispozitave të seksionit 3.03 të mësipërm, çdo pagesë e mëtejshme do të gjykohet të jetë kryer në mënyrë të rregullt, kur një prej bankave të mëposhtme i konfirmon Bankës për arkëtimin prej saj të kësaj pagese në llogarinë e Bankës:

a) Nëse kjo pagesë është bërë në dollarë amerikanë:
Llogaria nr. IBAN GB36SINT 609 28000 159111
Gulf International Bank (UK) Limited
One Knightsbridge, London SW1X 7XS
United Kingdom/Britania e Madhe
SWIFT CODE: SINTGB2L

b) Nëse kjo pagesë është bërë në paund britanikë:
Llogaria nr.122432 GBP2520 01
Gulf International Bank B.S.C.
London Branch, One Knightsbridge
London SW1X 7XS
United Kingdom/Britania e Madhe
Teleks Nr. 8812889/8813326 GIBANK G
SWIFT CODE: GULFGB2L

c) Nëse kjo pagesë është bërë në monedhën euro:
Llogaria nr. IBAN FR76 4389 9000 0196 9650 0151 088
(Union de Banques Arabes et Francaises (UBAF)/
Bashkimi i Bankave Arabe dhe Franceze (BBAF)
92523 Paris, Neuilly Cedex, Francë
Teleks Nr. 610334 UBAF

SWIFT CODE: UBAFRPPXXX

Neni 5

Zbatimi i Projektit

Seksioni 5.01 Huamarrësi merr përsipër:

a) të zbatojë projektin dhe të drejtojë punimet e tij, përmes agjencisë së zbatimit, me përkushtim dhe efektivitet në përputhje me të gjitha praktikat e domosdoshme administrative, financiare, inxhinierike dhe ekonomike, nën mbikëqyrjen e personelit dhe drejtuesve të kualifikuar dhe me përvojë, si dhe në përputhje me planin e investimit, buxhetit, planifikimet dhe specifikimet lidhur me Projektin që i është dorëzuar Bankës dhe që është miratuar prej saj;

b) të paraqesë, në mënyrë të detajuar, sipas kërkesave të Bankës, me qëllim miratimi nga ana e saj, të çdo ndryshimi të dukshëm që ndodh në buxhetin, planet dhe specifikimet e Projektit, si dhe çdo ndryshim thelbësor në secilën prej kontratave për shërbime ose prokurim mallrash që kanë të bëjnë me zbatimin e Projektit.

Seksioni 5.02 Pa ndonjë kufizim ose pengesë mbi detyrimet e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do t'i lejojë Bankës një periudhë kohe të arsyeshme për të dhënë mendimet e veta mbi çdo ndryshim thelbësor ose çdo shtesë të periudhës së rënë dakord në secilën nga kontratat për shërbime ose prokurime mallrash, lidhur me zbatimin e Projektit.

Neni 6

Parakushte shtesë përpara disbursimit nga ana e Bankës

Huamarrësi, para se të dorëzojë kërkesën e parë për tërheqjen e fondit, do të paraqesë procedurën që propozon të ndiqet ose që do të ndikojë me qëllim që të vazhdojë procedura për prokurim konkurrues në zbatim të seksionit 2.02 dhe 7.02 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe do të marrë miratimin e Bankës përsa më sipër.

Neni 7

Dispozita të veçanta

Seksioni 7.01 Huamarrësi do të vërë në dispozicion, sapo t'i kërkohet, të gjitha shumat që përfshijnë sasitë e nevojshme për kostot në monedhë vendase dhe kosto shtesë që do të nevojiten për vijueshmërinë e Projektit, sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën.

Seksioni 7.02 Përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi do të trajtojë të gjitha kontratat që financohen nga vazhdimësia e kësaj huaje për zbatimin e Projektit përmes procedurave të tenderit të hapur ndërkombëtar dhe do të kërkojë miratim paraprak nga Banka për shpalljen fituese të çdo kontrate, vlera e së cilës tejkalon shumën ekuivalente prej njëqind e pesëdhjetë mijë dinarë islamikë (DI 150,000).

Seksioni 7.03 Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës, menjëherë pas miratimit prej tij, studimet dhe planet specifike të Projektit, afatet e zbatimit të tij dhe çdo ndryshim thelbësor që u bëhet atyre ,në një mënyrë të detajuar, sipas kërkesave të herëpashershme nga ana e Bankës.

Seksioni 7.04 Huamarrësi do të çelë dhe do të mbajë regjistra të përshtatshëm për të identifikuar mallrat e financuara nga vijueshmëria e huasë, me qëllim që të bëjë publik përdorimin e tyre në projekt, të dokumentojë ecurinë e Projektit dhe të pasqyrojë në përputhje me praktikat e konsoliduara të kontabilitetit veprimet dhe pozitën financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.05 Huamarrësi do të përballojë të gjitha rastet e arsyetuara për vizita nga përfaqësuesit e akreditуar të Bankës me qëllime të lidhura me huanë, si dhe për të kontrolluar Projektin, mallrat dhe çdo dokument dhe regjistër tjetër përkatës, si dhe do t'i paraqesë Bankës të gjitha informacionet sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës, lidhur me shpenzimet sipas ecurisë së huasë, projektit, mallrave dhe veprimeve, si dhe të pozitës financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.06 Me qëllim kryerjen dhe zbatimin e projektit, Huamarrësi angazhohet të marrë të gjitha masat e duhura në mënyrë që institucioni zbatues të funksionojë gjatë gjithë kohës, në përputhje me rregullat dhe udhëzimet, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, si dhe të ketë aftësi administrative dhe drejtuese të përshtatshme për ecurinë e nevojshme dhe efikase të veprimtarisë së Projektit.

Seksioni 7.07 Huamarrësi do të sigurojë ose ndikojë për pajisjen me sigurime të besueshme të gjitha mallrat e financuara nga zbatimi i huasë. Këto sigurime do të mbulojnë transportin detar, transit dhe rreziqe të tjera rastësore për blerjen dhe importimin e mallrave në territorin e Huamarrësit dhe dërgimin e tyre në vendin e zbatimit të projektit dhe do të sigurohen në shuma që janë në përputhje me praktikat tregtare të qëndrueshme. Këto sigurime do të bëhen në përputhje me legjislacionin e Huamarrësit sipas marrëveshjes se mallrat do të risigurohen në një shoqëri që do të paguajë shumat e sigurimit në monedhë lehtësisht të shkëmbyeshme.

Seksioni 7.08 Huamarrësi do të veprojë në atë masë që gjykohet si e arsyeshme për të disponuar truallin e nevojshëm dhe të drejtat e lidhura me të, siç kërkohet për realizimin e Projektit dhe do t'i paraqesë Bankës, me kërkesën e kësaj të fundit, prova të mjaftueshme se trualli dhe të drejtat e lidhura me të janë vënë në shërbim të realizimit të projektit.

Seksioni 7.09 Huamarrësi do të ndërmarrë veprime nga ana e vet kur të jetë e nevojshme për të lejuar institucionin zbatues të realizojë projektin dhe nuk do të ndërmarrë ose lejojë të ndërmerret ndonjë veprim që mund të ndalojë ose ndërhyjë në zbatimin, ose veprimtarinë e projektit, ose në përmbushjen e çdonjërës prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.10 Të gjitha dokumentet e Bankës, regjistrat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të konsiderohen nga Banka dhe nga Huamarrësi si çështje konfidenciale.

Neni 8
Raportet

Seksioni 8.01

a) Huamarrësi dhe Banka do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar se do të përmbushin objektivat e huasë. Për këtë qëllim, secili prej tyre do t'i dorëzojë tjetrit informacionin e duhur sipas kërkesës së arsyetuar, lidhur me gjendjen e përgjithshme të huasë. Nga ana e Huamarrësit, ky informacion do të përfshijë të dhëna lidhur me kushtet ekonomike dhe financiare në shtetin e Huamarrësit dhe gjendjen e bilancit të pagesave të Huamarrësit.

b) Huamarrësi dhe Banka, në mënyrë të herëpashershme dhe mbi bazë të kërkesës së secilës Palë, do të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre, përmes përfaqësuesve përkatës, përsa i takon çështjeve që kanë të bëjnë me qëllimet e huasë, mbështetjen me shërbimet përkatëse dhe përmbushjen e detyrimeve nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 8.02

a) Huamarrësi angazhohet të kryejë dorëzimin ose të ndikojë për dorëzimin, në Bankë, të secilit prej raporteve të mëposhtme, duke përmbushur tërësisht kërkesat e kësaj të fundit dhe në kohën e përcaktuar:

i) brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbarimi i secilit tremujor ose brenda ndonjë periudhe tjetër që Palët mund të bien dakord, raporte për zbatimin e projektit në atë mënyrë që Banka do të kërkojë herë pas here;

ii) raporte të tjera që Banka, në mënyrë të arsyetuar, do të kërkojë lidhur me investimin e shumës së huasë të disbursuar dhe ecurinë e Projektit;

iii) menjëherë pas përfundimit të Projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës përfundimtare ose një date të mëvonshme, siç mund të bihet dakord për këtë qëllim nga Huamarrësi dhe Banka, Huamarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Bankës një raport të plotë me qëllimet dhe detajet përkatëse, sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës, lidhur me zbatimin dhe veprimet fillestare të Projektit.

b) Dokumentet e përshkruara në këtë seksion do të noterizohen sipas vullnetit të lirë

të Bankës, në atë mënyrë që Banka do ta gjykojë të arsyeshme.

Neni 9
Vlefshmëria

Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi deri sa:

A) (1) Bankës t'i jepen evidenca të kënaqshme lidhur me zbatimin dhe ndjekjen e kësaj Marrëveshjeje prej Huamarrësit sipas autorizimit përkatës ose ratifikimit nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë;

2) opinioni ligjor që rrjedh nga autoriteti ligjor i Republikës së Shqipërisë, që deklaron se:

i) lidhja e marrëveshjes nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Bankës është në pajtim me Kushtetutën dhe të gjitha ligjet e tjera përkatëse në fuqi në Republikën e Shqipërisë; dhe

ii) termat dhe kushtet e marrëveshjes përbëjnë detyrime të zbatueshme detyruese mbi Republikën e Shqipërisë, të jetë i pranueshëm për Bankën.

B) Një letër autorizimi do të lëshohet nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion tjetër i autorizuar për këtë qëllim nga ana e Huamarrësit për Bankën qendrore, ose subjektin që ushtron funksionet e një banke qendrore, se pagesa nga Huamarrësi në përputhje me këtë Marrëveshje të shumës themelore dhe kështet e tarifës së shërbimit do të bëhen nga banka qendrore ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, në datat e përcaktuara.

C) një vërtetim nga Banka Qendrore ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, i cili demonstron se është marrë letra e autorizimit dhe se do t'i bashkëlidhet udhëzimeve të përfshira në të do t'i dërgohet Bankës nga Huamarrësi.

Neni 10
Përfundimi i marrëveshjes për moszbatueshmëri

Nëse Marrëveshja nuk hyn në fuqi para datës 22.1.2007, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve të përfshira këtu do të shuhen, përveç se kur Banka pas marrjes në konsideratë të të gjitha shkaqeve të vonesës, do të përcaktojë një datë të mëvonshme për qëllime të këtij neni. Banka menjëherë do të njoftojë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 11
Dispozita të ndryshme

Seksioni 11.01 Përfaqësuesit e autorizuar. Ministri i Financave i Huamarrësit dhe çdo person ose persona që ai do të caktojë me shkrim do të konsiderohen si përfaqësuesit e autorizuar të Huamarrësit për qëllime të seksionit 10.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 11.02 Data e Marrëveshjes. Për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, data e Marrëveshjes do të jetë ajo që shfaqet në pjesën hyrëse të saj.

Seksioni 11.03 Adresa. Adresat e mëposhtme janë dhënë për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:
Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.1
Tiranë, Shqipëri.
Telefon: ++355 4 228 405
Fax.: ++355 4 228 494
Për Bankën Islamike për Zhvillim:
P.O. Box: 5925
Jeddah 21432, Mbretëria e Arabisë Saudite

Teleks: 601137 ISDB SJ
Kabëll: BANKISLAMI JEDDAH
Telefaks: 6366871 JEDDAH

Për sa më sipër, Banka dhe Kredimarrësi, secili duke vepruar me anë të përfaqësuesve të vet të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze në datën dhe vitin e paraqitur më sipër.

TABELA I
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Fusha e veprimit të Projektit përfshin aktivitetet e mëposhtme:

A. Ndërtimi i mjediseve të portit

A1- Masat paraprake dhe rruga hyrëse: Ky nënkomponent ka të bëjë me kostot e mobilizimit dhe çmobilizimit dhe ndërtimin e rrugës hyrëse 600 metra të gjatë dhe 6.0 metra të gjerë për në portin e peshkimit.

A2- Bonifikimi i tokës (0.8 hektarë): një zonë rreth 0.8 hektarë do të bonifikohet në qendër të pengesës dallgëpritëse kryesore.

A3- Pengesa dallgëpritëse kryesore (600 m): Pengesa dallgëpritëse kryesore do të jetë me bazë gurësh të palatuar, me gjatësi totale prej 600 metrash.

A4- Pengesa dallgëpritëse e bregut të mbrojtur nga era (96 metra): Gjatësia e pengesës dallgëpritëse të bregut të mbrojtur nga era nga vija e pengesës dallgëpritëse ekzistuese do të jetë 96 metra.

A5- Bankina e bregut (175 metra): duke përshkuar gjatësinë e basenit në 175 metra, bankina e bregut do të formojë bazën e pengesave dallgëpritëse.

A6- Pengesat dallgëpritëse: tre pengesa dallgëpritëse do të ndërtohen për zonën e bllokuar. Një pengesë dallgëpritëse do të jetë e ngurtë dhe dylundruese. Çdo pengesë dallgëpritëse do të jetë afërsisht 81 metra e gjatë dhe 4.7 metra e gjerë.

A7- Ndërtesat e portit dhe parcelat tregtare: Ndërtesat e portit të peshkimit do të përmbajnë:

- Ndërtesën FMO, 500 m2 mbi dy kate;
- Bllokun e higjienës, 35 m2 dhe nënstacionin, 9 m2;
- Vendrojën, 3 m2 dhe mjedisin e shitjes së karburantit, 1.8 m2 (kabina modulare).

Porti do të pajiset me zona shërbimesh (ujë i pijshëm, ujërat e zeza, energjia dhe shërbimet telefonike) për tre godina tregtare që do të krijohen në mënyrë të pavarur nga palët e treta të përfshira në eksportin e prodhimeve të peshkut dhe peshkimit. Çdo zonë do të jetë 15 m x 16.5 m, por asnjë konstruksion godine nuk është parashikuar nga projekti.

A8 - Shërbime komunale

i) Furnizimi me ujë të pijshëm;
ii) Mjediset e ujërave të zeza;
iii) Furnizimi me karburant;
iv) Furnizimi me energji elektrike;
v) Telefon, komunikimet VHF detare dhe shërbime të tjera.

B. Shërbime konsulence

Komponenti përbëhet prej përzgjedhjes së një firme konsulente: i) për të përgatitur projektimin e detajuar inxhinierik, (ii) për të përgatitur dokumentet e ofertimit, (iii) për të asistuar agjencinë ekzekutuese në procesin e prokurimit dhe (iv) për të mbikëqyrur punimet gjatë fazës së ndërtimit.

C. Njësia e menaxhimit të Projektit (NJMP)

Një njësi e menaxhimit të Projektit do të krijohet në Tiranë, nën varësinë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Është propozuar që NJMP - ja do të pajiset me personel me kohë të plotë si më poshtë: (i) Drejtori i NJMP, (ii) inxhinieri civil, (iii) specialisti i prokurimit, (iv) oficeri i disbursimit/menaxhimit financiar dhe (v) shoferi.

Projekti do të mbajë stafin kryesor të PMU-së ekzistuese të Bankës Botërore për Projektin Pilot të Zhvillimit të Peshkimit.

Projekti do të financojë pagat për anëtarët e stafit të NJMP-së, si dhe kostot e tij

operacionale dhe përvetësimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe një automjet. Gjithashtu, do të organizohet një vizitë familjarizuese në Bankën e Zhvillimit Islamik për anëtarët e stafit të NJMP - së dhe një seminar njohës.

D. Auditimi financiar

Një firmë e kualifikuar, e pavarur auditimi, do të përzgjidhet me qëllim që të auditojë deklaratat financiare të projektit.

TABELA II (A)
RIPAGESAT E SHUMËS THEMELORE

Shteti: Republika e Shqipërisë
Projekti: Porti i peshkimit në Durrës
Shuma e huasë: DI 6,13 milionë
Periudha e huasë: 25 vjet.
Periudha e shtyrjes: 7 vjet.
Tarifa e shërbimit: DI 558,700.46.

Numër	Datë	Shuma themelore (Principali) (DI)
1	31.12. 2013	170,277.78
2	30.06. 2014	170,277.78
3	31.12. 2014	170,277.78
4	30.06. 2015	170,277.78
5	31.12. 2015	170,277.78
6	30.06. 2016	170,277.78
7	31.12. 2016	170,277.78
8	30.06. 2017	170,277.78
9	31.12. 2017	170,277.78
10	30.06. 2018	170,277.78
11	31.12. 2018	170,277.78
12	30.06. 2019	170,277.78
13	31.12. 2019	170,277.78
14	30.06. 2020	170,277.78
15	31.12. 2020	170,277.78
16	30.06. 2021	170,277.78
17	31.12. 2021	170,277.78
18	30.06. 2022	170,277.78
19	31.12. 2022	170,277.78
20	30.06. 2023	170,277.78
21	31.12. 2023	170,277.78
22	30.06. 2024	170,277.78
23	31.12. 2024	170,277.78
24	30.06. 2025	170,277.78
25	31.12. 2025	170,277.78
26	30.06. 2026	170,277.78
27	31.12. 2026	170,277.78
28	30.06. 2027	170,277.78
29	31.12. 2027	170,277.78
30	30.06. 2028	170,277.78
31	31.12. 2028	170,277.78
32	30.06. 2029	170,277.78
33	31.12. 2029	170,277.78
34	30.06. 2030	170,277.78

35	31.12. 2030	170,277.78
36	30.06. 2031	170,277.78
Totali:		6,130,000.00

TABELA II (B)
PAGESA E TARIFËS SË SHËRBIMIT

Shteti: Republika e Shqipërisë
Projekti: Porti i peshkimit në Durrës
Shuma e huasë: DI 6,13 milionë
Periudha e huasë: 25 vjet.
Periudha e shtyrjes: 7 vjet.
Tarifa e shërbimit: DI 558,700.46

Numër	Datë	Shuma Themelore (Principali) (DI)
1	31.12.2006	11,174.01
2	30.06.2007	11,174.01
3	31.12.2007	31,925.74
4	30.06.2008	31,925.75
5	31.12.2008	31,925.76
6	30.06.2009	31,925.77
7	31.12.2009	31,925.78
8	30.06.2010	31,925.79
9	31.12.2010	31,925.80
10	30.06.2011	31,287.23
11	31.12.2011	31,287.23
12	30.06.2012	31,287.23
13	31.12.2012	31,287.23
14	30.06.2013	31,287.23
15	31.12.2013	31,287.23
16	30.06.2014	31,287.23
17	31.12.2014	31,287.23
18	30.06.2015	31,287.23
19	31.12.2015	31,287.23
Totali:		558,700.46

TABELA III
TËRHEQJA E TË ARDHURAVE TË HUASË

Shuma e të ardhurave të huasë së Bankës Islamike për Zhvillim prej DI 6,13 milionë (afërsisht e barazvlefshme me 8.77 milionë dollarë amerikanë) do të tërhiqet për të mbuluar kostot e zërave si më poshtë:

Komponenti	BIZH			Qeveria		Totali %	BIZH
	L.C	F.C	Totali	L.C	Totali		
A- Ndërtimi i mjediseve të portit	2.00	4.75	6.75	1.10	1.10	7.85	86%
B- Shërbimet e konsulencës	0.20	0.31	0.51	-	-	-	100%
C- Njësia e menaxhimit të Projektit (NJMP)	0.27	0.05	0.32	0.02	0.02	0.34	94%
D- Kontrolli financiar	0.05	0.00	0.05	-	-	-	100%

Kostoja bazë	2.52	5.11	7.63	1.12	1.12	8.75	87%
Kontingjencat fizike (10 %)	0.25	0.51	0.76	0.11	0.11	0.87	
Kontingjencat e çmimit (5 %)	0.13	0.25	0.38	0.05	0.05	0.43	
Totali	2.90	5.87	8.77	1.28	1.28	10.05	87%